



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Keshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 215, date 16.04.2004

PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE VENDIMIN NR. 711, DATE 27/12/2001, TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER STRUKTURAT DHE NIVELET E PAGAVE TE NEPUNESVE CIVILE NE INSTITUCIONET E ADMINISTRATES QENDRORE,

ADMINISTRATES SE PRESIDENTIT DHE KUVENDIT DHE DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE VENDIMIN E NR.726, DATE 21.12.2000, TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER PAGAT E PUNONJESVE TE INSTITUCIONEVE BUXHETORE", NDRYSHUAR ME VENDIMET NR. 39, DATE 26.01.2001, NR.158, DATE 22.03.2001, NR.167, DATE 30.03.2001, NR.174, DATE 30.03.2001, NR. 197, DATE 6.04.2001, NR. 358, DATE 31.05.2001 DHE NR. 424, DATE 11.06.2001, TE KESHILLIT TE MINISTRAVE"

Ne mbeshtetje te Nenit 100 te Kushtetutes, Nenit 29 dhe 18 te Ligjit Nr. 8549, date 11.11.1999 "Statusi i Nepunesit Civil" dhe te Nenit 5/1 te Ligjit nr. 8487, date 13.5.1999 "Per kompetencat per caktimin e pagave te punes", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit te Shtetit per Koordinimin, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ne Vendimin Nr. 711, date 27/12/2001, te Keshillit te Ministrave behen keto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikes "5" shtohet pika "5/1" me kete permbajtje:

"5.1 Specialistet" apo "pergjegjesat e sektorit" ne "institucionet e administrates qendrore", administrates se Presidentit dhe Kuvendit qe punojne ne pozicione qe lidhen me procesin e informatizimit te veprimtarise se administrates publike dhe kerkojne ne menyre te detyrueshme arsimin e larte ne deget "inxhinieri elektronike" apo "informatike", perfitojne nje shtese per "kushte pune" prej 15.000 leke mbi pagen mujore te kategorise perkatese. Zbatimi i kesaj shtese per pozicionet konkrete behet pas miratimit paraprak te Departamentit te Administrates Publike, ne baze te pershkrimit te pozicioneve te punes per keto pozicione".

b) Pas pikes "6" shtohet pika 6/1 me kete permbajtje:

"6.1 Kategorizimi per funksionet e veçanta eshte sipas Lidhjes nr. 3, bashkelidhur dhe pjese perberese e ketij vendimi".

c) Ne shkronjen "a", te pikes 7, emertesa "shef kabinetit i ministrit", zevendesohet me emertesën "drejtor i kabinetit te ministrit"

ç) Pika 11 e vendimit, shfuqizohet.

2- Efektet financiare per kete vit perballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar per institucionet perkatese.

3- Vendimi Nr. 348, date 27/06/2002, i Keshillit te Ministrave, "Per kategorizimin e pozicioneve te punes ne Keshillin e Ministrave", shfuqizohet.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren Zyrtare".

KRYEMINISTRI

FATOS NANO

LIDHJA NR. 3

**KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TE PUNES PER FUNKSIONET E
VEÇANTA NE KRYMINISTRI DHE MINISTRITE E LINJES**

INSTITUCIONI	POZICIONI	KATEGORIA E PAGES
	Drejtor i Njesise se Zbatimit te Projekteve te Bankes Boterore	II-a
	Drejtor i Njesise Antikorrupsion	II-a
	Koordinator prane Sekretarit te Pergjithshem	II-b
	Jurist ne Departamentin Juridik	II-b

	Inspektor ne Departamentin e Kontrollit te Brendshem Administrativ	II-b
	Koordinator ne Departamentin e Zhvillimit te Politikave dhe Koordinimit	II-b
	Pergjegjes sektori ne Departamentin e Administrates Publike	II-b
	Koordinator ne Njesine e Zbatimit te Projekteve te Bankes Boterore	III-a
Kryeministria		
Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale	Drejtor i Inspektoriatit Shteteror te Punes	II-a
	Perfaqesues Ligjor i Zyres se Perfaqesuesit Ligjor	II-b
Ministria e Puneve te Jashtme	Perfaqesues i Zyres se Minoriteteve	II-b
	Drejtor i Institutit te Diaspores	II-b
Ministria e Mjedisit	Kryeinspektor i Inspektoriatit te Mjedisit	III-a
	Inspektor ne Inspektoriatin e Mjedisit	III-b
Ministria e Drejtesise	Inspektor ne Drejtorine e Inspektimit Gjyqesor	III-a
Ministrite e linjes	Inspektor ne Drejtorite e Auditimit te Brendshem apo sektoret e Auditimit te Brendshem	III-b